



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 18.9.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT OPEC PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR (OFID), PËR PROJEKTIN E PUNIMEVE PËR RIPARIME EMERGJENTE TË AUTOSTRADËS TIRANË-ELBASAN”

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë - Elbasan”, në mbledhjen e datës 18 shtator 2018.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të Ministrisë për Infrastrukturën dhe Energjinë.

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë-Elbasan, në shumën prej 16 000 000 USD.

Projekti ka si qëllim rikuperimin e aksidenteve/rreziqeve gjeologjike përgjatë autostradës Tiranë – Elbasan (segmenti 1), duke përmirësuar qëndrueshmërinë e saj të përgjithshme operacionale dhe duke eliminuar rreziqet e sigurisë dhe mbylljet e rrugës për shkak të rrëshqitjeve të tokës.

Ky financim shtesë është i domosdoshëm për shkak të problematikave të shumta që janë hasur gjatë zbatimit të këtij projekti, siç janë problemet gjeologjike, e konkretisht, rrëshqitjet në km 11+100 (Ibë), km 13+150, km 14+000, apo lëvizjet gjeoteknike në zonën e Mulletit, km 4+000.

Realizimi i punimeve civile emergjente si pasoje e fenomeneve gjeologjike, të cilat reflektojnë humbjen e qëndrueshmërisë së shpateve rrugore dhe sollën si pasojë aktivizimin e rrëshqitjeve përgjatë gjurmës së projektit, si dhe shërbimet e konsulencës dhe të njësive të zbatimit të projektit, janë parashikuar të kryhen me një financim prej 16 milionë USD. Kjo hua është akorduar nga OFID dhe ka termat financiarë si më poshtë:

- Norma e interesit 2.75% në vit të shumës së principalit të Huasë së tërhequr dhe të papaguar.
- Detyrim Shërbimi vjetor në normën e njëpërqindshit 1% të shumës së principalit të Huasë së tërhequr dhe të papaguar.
- Interesi dhe Detyrimet e Shërbimit paguhen çdo gjashtë muaj më 15 shkurt dhe 15 gusht të çdo viti në Llogarinë e OFID-it.
- Maturimi është 20 vjet, duke përfshirë periudhën prej 5 vjetësh pa pagesë principali.
- Shlyerja do të kryhet në 30 këste gjashtëmujore.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare. Deputetët e opozitës nuk morën pjesë në mbledhje.

Eglantina GJERMENI

Eduard SHALSI

Relator

Kryetar